

Si funksionon

Nëse dëshiron atë që kemi për të ofruar dhe je i gatshëm të bësh përpjekjen për ta arritur, atëherë je gati të ndjekësh disa hapa. Këto janë parimet që bënë të mundur shërimin tonë.

1. Pranuam se ishim të pafuqishëm përballë varësisë sonë dhe se jeta jonë ishte bërë e pamënaxhueshme.
2. Arritëm të besonim se një Fuqi më e Madhe se ne mund të na rikthente në llogjikë.
3. Morëm vendimin të dorëzonim vullnetin dhe jetën tonë në kujdesin e Zotit të kuptimit tonë.
4. Bëmë një inventar moral kërkues dhe të patrembur të vetes sonë.
5. Pranuam para Zotit, para vetes tonë dhe para një njeriu tjetër natyrën e saktë të gabimeve tona.
6. Ishim plotësisht gati që Zoti t'i largonte të gjitha këto të meta të karakterit.
7. Me përlësi i kërkua Atij të largonte të metat tona.
8. Bëmë një listë të të gjithë personave që kishim dëmtuar dhe u bëmë të gatshëm të bënim dëmshpërblime ndaj tyre.
9. Bëmë dëmshpërblime të drejtpërdrejta ndaj këtyre njerëzve kudo që ishte e mundur, përveç rasteve kur kjo do t'i dëmtonte ata ose të tjerët.
10. Vazhduam të bënim inventar personal dhe kur gabuam, e pranuam menjëherë.
11. Kërkua përmes lutjes dhe meditimit të përmirësonim kontaktin tonë të vetëdijshtë me Zotin sipas kuptimit tonë për Të, duke u lutur vetëm për njohjen e vullnetit të Tij për ne dhe fuqinë për ta zbatuar atë.
12. Duke pasur një zgjim shpirtëror si rezultat i këtyre hapave, u përpoqëm ta çonim këtë mesazh te të varurit e tjerë dhe t'i zbatonim këto parime në të gjitha çështjet e jetës sonë.

Kjo duket si një detyrë e madhe dhe nuk mund ta bëjmë vetëm. Nuk u varëm nga droga brenda një dite, prandaj kujtohu: ngadalë – ngadalë.

Ekziston diçka mbi çdo gjë tjetër që mund ta mposhtë shërimin tonë. Ky është një qëndrim indiferent ose mungesë tolerance ndaj parimeve tona shpirtërore. Tre prej tyre janë thelbësore: sinqeriteti, mendja e hapur dhe gatishmëria. Me këto jemi në rrugë të mirë.

Ndiejmë se mënyra me të cilën përballemi me sëmundjen e varësisë është plotësisht realiste, sepse vlera terapeutike e një të varuri që ndihmon një tjetër nuk ka të krahasuar. Ndiejmë se mënyra jonë është praktike, sepse një i varur mund ta kuptojë dhe ta ndihmojë më mirë një tjetër të varur. Besojmë se sa më shpejt t'i përballojmë problemet tona brenda shoqërisë dhe në jetën tonë të përditshme, aq më shpejt bëhemi anëtarë të pranueshëm, të përgjegjshëm dhe krijues të kësaj shoqërie.

Mënyra e vetme për të mos u kthyer në varësinë aktive është të mos marrim drogën e parë. Nëse je si ne, e di se një është shumë dhe një mijë nuk janë kurrë të mjaftueshme. I japim shumë rëndësi kësaj, sepse e dimë që, kur përdorim droga në çfarëdo forme ose zëvendësojmë njërën me një tjetër, e çlirojmë varësinë tonë përsëri që nga fillimi.

Ideja se alkoli është ndryshe nga drogat e tjera ka çuar shumë të varur në rikthim të përdorimit. Para se të vinim në NA, shumë prej nesh e ndanim alkolin nga drogat e tjera, por nuk duhet të ketë as më të voglin konfuzion për këtë çështje. Alkoli është drogë. Ne jemi njerëz me sëmundjen e varësisë që duhet të abstenojmë nga të gjitha drogat në mënyrë që të shërohemi.